



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT

Nr. 05 - 497

Podujevë,

27.07.2021

Në bazë të nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikës së Kosovës, nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik (MPMS), UA. nr. 26/2013 Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucionet edukative-arsimore (MASHT), UA. nr. 34/2014 Funkcionalizimi i shërbimit pedagogjik-psikologjik në shkolla (MASHT), Drejtoria për Arsimit shpallë:

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

**Pozita: 4 (katër) psikolog shkolle në shkollat e komunës së Podujevës
1 (një) psikolog shkolle në SHFMU “ Naim Frashëri “ Podujevë, deri sa të
kthehet psikologjia nga pushimi i lehonisë**

Koeficienti: 6

Orari i punës : 40 orë në javë

Detyrat kryesore të punës :

- Psikologu i shkollës kontribuon në lehtësimin e procesit të të nxënësve dhe promovon zhvillimin kognitiv, emocional dhe personal të nxënësve;
- Ofron ndihmë në tejkalimin e vështirësive të natyrës psikologjike me të gjithë akterët në shkollë;
- Vlerëson dhe interpreton çështjet që kanë të bëjnë me procesin e të nxënësve dhe zhvillimin kognitiv, social, personal dhe emocional të nxënësve;
- Asiston dhe ofron ndihmë në identifikimin nxënësve me vështirësi në të nxënësve të talentuar, identifikon dhe vlerëson nevojat e nxënësve, bashkëpunon me profesionistë tjerë dhe zbaton vlerësime të përshtatshëm (të besueshme dhe valide), zhvillon intervista me nxënës, mësues, prindër, vëzhgime e procedura të ndryshme me qëllim të vlerësimit objektiv, propozon dhe zbaton masa për intervenime psikoedukative individuale dhe në grup.
- Punon drejtpërdrejtë me nxënës, këshillon nxënësit të cilët kanë nevojë për ndihmë në mësim, punë vazhduese, i këshillon në zgjedhjen e profesionit dhe për tejkalimin e problemeve personale;

- Bashkëpunon me mësimdhënës, prindër dhe komunitet;
- Bashkëpunon me institucionet profesionale; me organet profesionale të shkollës, bashkëpunon edhe me institucione tjera sociale, shëndetësore, organizata joqeveritare, të cilat i kontribuojnë mirëqenies së nxënësve dhe personelit shkollor dhe ndihmojnë në realizimin e qëllimit dhe detyrave profesionale.
- Kryen edhe detyra tjera profesionale të caktuara nga drejtori i institucionit dhe punëdhënësi.

I. KUSHTET:

- Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës,
- Të kenë të kryer Fakulteti Filozofik, MA i Psikologjisë - Drejtimi psikologji shkollore dhe këshillim,
- Të kenë certifikë të trajnimeve të akredituara, për ofrimin e shërbimeve dhe trajtimin e fëmijëve me nevoja të veçanta,
- Të kenë njohuri të punës me kompjuter (word, excel, power point, access, internetit).

II. Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (i cili merret dhe dorëzohet në qendrën për shërbime të qytetarëve,
- Certifikata e lindjes,
- Dokumentin personal – letërnjoftimi ose pasaporta (kopje),
- Dëshmi mbi kualifikimin (kopja e vërtetuar),
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmi që nuk jeni i/e ndjekur penalisht,
- Certifikatën e mjekut (vetëm kandidati i cili pranohet në marrëdhënie pune, pra pas publikimit të rezultateve).
- **Sqarim shtesë:**
 - Informatat e dhëna në aplikacion konsiderohen të vlefshme vetëm nëse dëshmohen me dokumente,
 - Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet t'i kenë të nostrifikuara dokumentet në MASHT,
 - Në intervistë ftohen kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit,
 - Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen,
 - Dokumentet nuk kthehen.
- **Afati i konkursit**
Konkursi mbetet i hapur 15 ditë kalendarike, nga dita e shpalljes së konkursit, në tabelën e shpalljeve të objektit të komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës: <http://kk.rks-gov.net/podujeve>, gjegjësisht deri më datën 10.08.2021.

drejtori

Avni Fetahu



(Handwritten signature of Avni Fetahu)